

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"V&S Group" SH.P.K

Sot, më datë 16.02.2023,

Elvis Sulja, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 12/11/1987, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035667197 dhe Nr. Personal *I71112065B* zotëron 2 kuota duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**V&S Group**" Sh.P.K. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**V&S Group**" Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Aktivitete të mirëmbajtjes, lyerje të fasadave dhe tregti e bojrave të të gjitha llojeve, tregtim dhe montim gipsi, tregtim dhe instalime elektrike, tregtim dhe instalime hidraulike, tregtim dhe montim të paneleve diellore.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**V&S Group**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Aktivitete të mirëmbajtjes, lyerje të fasadave dhe tregti e bojrave të të gjitha llojeve, tregtim dhe montim gipsi, tregtim dhe instalime elektrike, tregtim dhe instalime hidraulike, tregtim dhe montim të paneleve diellore.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Shkodër, Rruga e Mbretit Gent, Nr.pasurie 1/288, zona kadastrale 8591.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **600,000** (Gjashtëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 kuota ku secila kuotë ka vlerën 300,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin **“V&S Group” Sh.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Elvis Sulja, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 12/11/1987, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035667197 dhe Nr. Personal *I71112065B* zotëron 2 kuota duke përfaqësuar 100% te kapitalit ku një kuotë ka vlerën 300,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Z. Elvis Sulja**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 12/11/1987, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035667197 dhe Nr. Personal *I71112065B* me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Elvis Sulja

ELVIS SULJA

